



- [Të reja](#) [Kush jemi](#) [Historiku](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet](#) [Video](#) [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#) [Donacione](#) [Policimi në Komunitet](#)
- [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#) [Të Guximshëm Pa Armë](#)

Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 16 korrik 2024
Korçë – RENEА neutralizon dhe vë në pranga 71-vjeçarin që qëlloi me armë zjarri, në ajër, nga ballkoni i banesës së tij
Velipojë – Kapet 1 shtetas që ishte në kërkim
Kavajë/Informacion sqarues
Drejtoria Vendore e Policisë Gjrokastër, gjatë 24 orëve të fundit



Lajmet

16/07/2024

Velipojë – Kapet 1 Shtetas Që Ishte Në Kërkim

Velipojë/Vijojnë kontrollet në kuadër të megaoperacionit policor mbarëkombëtar të koduar “Sundimi i ligjit”.

Kanosi me armë zjarri pistoletë, një shtetas, gjatë një konflikti të çastit, në një lokal në fshatin Pulaj, kapet dhe ndalohet 33-vjeçari i shpallur në kërkim.

Shërbimet e Stacionit të Policisë Velipojë, në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional “Sundimi i ligjit”, bazuar në informacionet e siguruara nga intelijenca policore mbi vendndodhjen e një shtetasi në kërkim, kanë organizuar punën për kapjen dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë ligjore.

Si rezultat i kontrolleve, u kap shtetasi në kërkim E. I., 33 vjeç, banues në Shkodër.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi dyshohet se më datë 28.06.2024, në një lokal në fshatin Pulaj, ka kanosur me armë zjarri pistoletë, kuzhinierin e lokalit, shtetasin A. F., 33 vjeç, banues në Vaun e Dejës, pasi ky i fundit ishte konfliktuar për motive të dobëta me shtetasin E. H., 20 vjeç, kamerier i lokalit (i afërm i shtetasit E. I.).

Arma e zjarrit pistoletë është sekuestruar nga shërbimet e Policisë, pas konfliktit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

◀ Kavajë/Informacion sqarues

Korçë – RENEА neutralizon dhe vë në pranga 71-vjeçarin që qëlloi me armë zjarri, në ajër, nga ballkoni i banesës së tij ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)